

# RAPORT NDËRKOMBËTAR PËR LIRINË E FESË

## SHQIPËRIA 2016

### Përmbledhje e përgjithshme

Kushtetuta garanton lirinë e ndërgjegjes dhe fesë. Ajo përcakton se nuk ka fe zyrtare, shteti është asnjans në çështjet e besimit, njeh barazinë dhe pavarësinë e grupeve fetare, dhe ndalon diskriminimin. Qeveria ka patur marrëveshje me komunitetet mysliman suni dhe bektashi, me kishat katolike dhe ortodokse, me vëllazërinë ungjillore të Shqipërisë (VUSH), një organizatë protestante ombrellë, në lidhje me njohjen, kthimin e pronave dhe marrëveshje të tjera. Ligji përcakton se komunitetet fetare do të marrin mbështetje financiare nga qeveria, por marrëveshja e qeverisë me VUSH, sipas ligjit, nuk e përcakton atë në veçanti si marrëse të këtij financimi. Përgjatë vitit, qeveria legalizoi 137 xhami, në krahasim me 6 nga viti i kaluar. Grupet fetare raportuan njëfarë zhvillimi mbi qindra pretendime ndaj qeverisë për kompensim ose kthim të pronave të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit, dhe se Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) u takua me ta për të nisur përpilimin e listës së pretendimeve për prona. Drejtuesit e VUSH-it deklaruan se kishat e tyre vijuan të kenë probleme në marrjen e tokave për të ndërtuar objekte kulturi dhe vazhduan të përballen me probleme në lidhje me pagesat e taksave. Kryeministri shpalli një projekt pilot i cili përfshinte 10 shkolla dhe synonte nxitjen e tolerancës fetare në shkollat e mesme si një mënyrë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i cili duhet të funksionojë si një forum ku drejtuesit e komuniteteve fetare të vendit diskutojnë mbi shqetësimet e përbashkëta, nuk u mblodh si vitet e kaluara. Papa Françesku mbajti një audiencë në Romë me drejtuesin e komunitetit botëror bektashi me qendër në Tiranë, audiencia e parë e tillë me Papën për çdo udhëheqës fetar të vendit.

Zyrtarë të ambasadës amerikane vazhduan të nxitnin zyrtarët e qeverisë për të përshpejtuar shqyrtimin e pretendimeve të mbetura pezull për pronat fetare dhe për t'u kthyer grupeve fetare ndërtesat, tokën dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit. Ambasada zgjeroi programin e saj për edukim qytetar, gjatë të cilit nxënës nga institucione të ndryshme arsimore fetare ndërtuan projekte që kremtonin shumëllojshmërinë fetare. Ambasada gjithashtu punoi me komunitete fetare dhe aktorë joqeveritarë për të shkurajuar ekstremizmin e dhunshëm të lidhur me fenë ndërmjet të rinjve, si dhe për të nxitur tolerancën fetare.

## **Seksioni I. Demografia fetare**

Qeveria e SHBA përllogarit popullsinë totale në 3 milionë (përllogaritje e korrikut 2016). Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, myslimanët suni përbëjnë afro 57 për qind të popullsisë, katolikët 10 për qind, anëtarët e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë afërsisht 7 për qind dhe anëtarët e Urdhrit Bektashi (një trajtë e sufizmit shia) në 2 për qind. Grupet e tjera përfshijnë besime protestante, bahai, Dëshmitarë të Jehovahit, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (mormonë) dhe një komunitet të vogël hebre. Afërsisht 20 për qind e personave refuzuan t'i përgjigjeshin pyetjes me zgjedhje për përkatësinë e tyre fetare.

## **Seksioni II. Gjendja e Respektimit të Lirisë së Fesë nga Qeveria**

### **Kuadri ligjor**

Kushtetuta përcakton se nuk ka fe zyrtare, të gjitha besimet janë të barabarta dhe se shteti ka detyrën të respektojë dhe mbrojë bashkëekzistencën fetare. Ajo përcakton se shteti është asnjans në çështjet e besimit dhe njeh pavarësinë e grupeve fetare. Sipas kushtetutës, marrëdhëniet mes shtetit dhe grupeve fetare rregullohen me marrëveshje ndërmjet këtyre grupeve dhe Këshillit të Ministrave, të miratuar nga kuvendi.

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e ndërgjegjes, fesë dhe shprehjes së lirë. Ajo deklaron se gjithkush është i lirë të zgjedhë ose ndryshojë fenë ose besimet e veta dhe t'i shprehë ato në mënyrë individuale, kolektive, në publik ose privatisht. Kushtetuta shpall gjithashtu se individët nuk mund të detyrohen të marrin pjesë ose të përjashtohen nga pjesëmarrja në komunitete ose praktika fetare, as të detyrohen të bëjnë publike besimet ose fetë e tyre apo të ndalohen t'i bëjnë këto nëse dëshirojnë. Ajo nuk lejon partitë politike ose grupe të tjera të nxisin urrejtje fetare.

Sipas ligjit, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr dhe përpunon ankesat për diskriminim, përfshirë ato që kanë të bëjnë me praktikën fetare. Ligji specifikon se Komiteti Shtetëror për Kultet, nën juridiksionin e Zyrës së Kryeministrit, rregullon marrëdhëniet mes qeverisë dhe grupeve fetare, mbron lirinë e fesë dhe nxit bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërfetar. Ligji gjithashtu e udhëzon këtë komitet të mbajë të dhëna dhe statistika mbi grupet e huaja fetare që

kërkojnë ndihmë, dhe të mbështesë punonjësit e huaj të grupeve fetare në marrjen e lejeve të qëndrimit.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare, por për t'u kualifikuar për përfitime të caktuara, përfshirë hapjen e një llogarie bankare, zotërimin e pronave dhe marrjen e pjeshme të statusit të përjashtimit nga taksat, një grup fetar duhet të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit si shoqatë jofitimprurëse. Procesi i regjistrimit kërkon dorëzim informacioni mbi formën dhe qëllimin e organizatës, veprimtarinë e saj, identitetet e themeluesve dhe përfaqësuesve ligjorë të saj, mënyrën e tyre të veprimit me aktorë të tjerë (p.sh. Ministra të qeverisë dhe organizata të qeverisë civile) në një fushë të caktuar, adresën e organizatës, dhe pagesën e një tarife prej 1.000 lekë (8 dollarë) pranë gjykatës së rrethit. Një gjykatës caktohet në mënyrë të rastësishme brenda 3-4 ditësh nga dorëzimi i aplikimit dhe procesi zakonisht përfundohet brenda një seance.

Qeveria ka marrëveshje me komunitetet e myslimanëve suni dhe bektashi, kishat katolike dhe ortodokse, si edhe me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë (VUSH). Marrëveshjet dypalëshe shërbejnë për të kodifikuar marrëveshjet që kanë të bëjnë me njohjen zyrtare, rikthimin e pronës, përjashtimin nga taksa mbi fitimin, donacione dhe prona fetare, dhe përjashtimin nga dorëzimi i të dhënave financiare për aktivitete fetare.

Një dispozitë ligjore e miratuar në 2009 përcakton se qeveria do të sigurojë mbështetje financiare për katër komunitetet fetare me të cilat ka pasur marrëveshje në të njëjtën periudhë. Kjo dispozitë ligjore nuk e përfshin VUSH-in, marrëveshja e së cilës me qeverinë daton në 2011. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që përcakton se VUSH duhet të marrë mbështetje financiare nga qeveria.

Ligji i kërkon ATP-së – më parë e quajtur Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave – t'u japë përgjigje pretendimeve nga grupet fetare për prona të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit.

Ligji lejon komunitetet fetare të drejtojnë institucione arsimore, si dhe të ndërtojnë dhe menaxhojnë varreza fetare në tokat që ato zotërojnë.

Shkollat publike janë laike dhe ligji ndalon mësimet fetare në to. Shkollat private mund të ofrojnë mësimet fetare. Sipas shifrave zyrtare, grupet, organizatat dhe fondacionet fetare kanë 125 shoqata dhe fondacione anëtare që menaxhojnë 116 institucione arsimore, përfshirë universitete, shkolla fillore dhe të mesme, kopshte, shkolla profesionale dhe jetimore. Sipas ligjit, këto shkolla duhet të licensohen nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe programi jofetar duhet të jetë në përputhje

me standardet kombëtare të arsimit. Grupet katolike, myslimane dhe ortodokse kanë në veprim një numër kopshtesh, shkollash dhe universitetesh të licensuara nga shteti. Shumica prej tyre nuk kanë orë fetare të detyruara por i ofrojnë ato me zgjedhje. Komuniteti mysliman ka shtatë medrese që japin mësimet fetare përpos programit të përcaktuar nga shteti.

Shqipëria është pjesë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

### **Praktikat Qeveritare**

Sipas përfaqësuesve të komuniteteve katolik, myslimanëve suni, ortodoks dhe bektashian, mbështetja financiare e qeverisë për këto katër grupe mbeti e njëjtë si në vitin 2015 me 109 milion lekë (850.000 dollarë), ku komuniteti mysliman mori 28% të shumës dhe tre komunitetet e tjera morën 24%. Financimi mbuloi një pjesë të rrogave për personelin e administratës dhe arsimit. Për komunitetin bektashi, i cili ka personel më të vogël, një pjesë e financimit të marrë u përdor për objekte të reja kulturi, si dhe për aktivitete globale të Qendrës Botërore Bektashiane me seli në Tiranë.

Pavarësisht kërkesave nga VUSH, qeveria vijoi të mos i ofrojë mbështetje financiare. Ajo nuk e amendoi marrëveshjen me VUSH për të shtuar sigurimin e mbështetjes financiare dhe as nuk amendoi ligjin për të përfshirë një mbështetje financiare të tillë.

Qeveria përshpejtoi procesin e legalizimit të xhamive jozyrtare dhe lëshoi 137 çertifikata pronësie, krahasuar me gjashtë nga viti i kaluar. Pjesa më e madhe e këtyre xhamive të paregjistruara ishin ndërtuar pa leje gjatë viteve 90. Qeveria kërkoi miratimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar për legalizimin e këtyre xhamive jozyrtare.

Grupet fetare raportuan se qeveria kishte bërë njëfarë progresi në lidhje me pretendimet e tyre për kthimin dhe kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë periudhës komuniste. Qeveria nuk ktheu asnjë pronë, por miratoi kompensimin e pjesshëm për 31 prona që i përkisnin kishës katolike, komunitetit mysliman shqiptar dhe komunitetit bektashian. Qeveria deklaroi gjithashtu se disa komunitete ende nuk kishin ndërmarrë hapat e duhura për kërkimin e fondeve.

Nga qindra pretendime të dorëzuara nga komunitetet fetare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave që prej rënies së komunizmit në 1990, pjesa më e madhe e

tyre mbetën të pazgjidhura. Për progresin e ngadaltë në lidhje me pretendimet, grupe fetare vijuan të fajësonin korrupsionin në qeveri, ndërlikimet ligjore që i kanë rrënjët në të shkuarën komuniste të vendit, si dhe pretendimet rivale për të njëjtat prona nga individë ose organizata private. ATP-ja pranoi se kishte problem në procesin e kompensimit, duke thënë se pretendimet rivale mbi pronat dhe ristrukturimi dhe përhapja e vazhdueshme e agjencive qeveritare të përfshira në shqyrtimin e pronave që prej 1990 nuk kishte mundur asnjë marrëveshje ndërmjet qeverisë dhe komuniteteve fetare mbi numrin e pretendimeve mbi pronat e vlefshme që janë dorëzuar në 25 vitet e fundit. ATP-ja u takua me komunitetet në mars për të nisur përpilimin e listës së pretendimeve të pronave dhe krijoi një forcë të posaçme për të ndjekur këto pretendime.

Edhe pse qeveria kishte premtuar të pastronte mbetjet nga vendi në Dhërmi ku Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor shkatërroi një kishë ortodokse në gusht të 2015, deri në fund të vitit vendi mbeti i paprekur. Premtimi për të gjetur një vend alternativ për një kishë të re mbeti gjithashtu i paplotësuar. Autoritetet vazhduan të deklarojnë se kisha ortodokse ishte ndërtuar pa leje në vendin ku më parë ekzistonte një kishë me rëndësi trashëgimie kulturore e shekullit të 17-të. Kisha Autoqefale e Shqipërisë vijoi të protestojë ndaj shkatërrimit.

Anëtarë të VUSH thanë se vazhduan të merrnin me qira ndërtesa ekzistuese për t'i përdorur si vende kulti dhe raportuan vështirësi të vazhdueshme në marrjen e tokës për të ngritur ndërtesat e tyre për shkak të përlogaritjeve dhe rregullave të qeverive vendore mbi taksat. Ata deklaruan se këto vështirësi penguan mundësitë e tyre për të kryer shërbime fetare dhe për të organizuar aktivitete rinore e sociale.

Ndërtimi vijoi në objektet e kultit bektashianë në Korçë, Përmet, Gjirokastrë dhe Elbasan. Edhe pse qeveria qendrore siguroi mbështetje financiare në ndërtimin e objekteve në Përmet dhe Gjirokastrë, përfaqësuesit bektashianë raportuan se mosmarrëveshjet mbi pronësinë me disa zyra të qeverive vendore në këto qytete e ngadalësuan zhvillimin.

Në prill, Kryeministri Edi Rama shpalli një projekt pilot në 10 nga shkollat e mesme të vendit, ku do të përfshihej një kurrikulë e re që syonte nxitjen e tolerancës fetare. Kryeministri dhe Ministrja e Arsimit deklaruan se kjo nismë nuk do të prekte sistemin arsimor laik shqiptar dhe do të shërbente si një mënyrë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Disa komunitete fetare shprehën pakënaqësi për atë që sipas tyre ishte këshillim i pjesshëm me ta përpara shpalljes. Udhëheqës fetarë shprehën gjithashtu edhe shqetësim në lidhje me aftësitë e mësuesve për të shpjeguar kurrikulën e re fetare, ashtu si edhe kapacitetet e vetë tyre për të

kontribuar në këtë nisëm. Megjithëse deri në fund të vitit qeveria nuk prezantoi një version të plotë të kurrikulës së re, ajo përfshiu pjesë të kurrikulës së re në lëndët e edukatës qytetare të shkollave të mesme.

Udhëheqësit e VUSH deklaruan se, në fillim të vitit, kishat e tyre vazhduan të hasen me problemin në lidhje me kërkesat mbi taksat vendore, veçanërisht në lidhje me taksat mbi pronat. Në maj, VUSH lidhi një marrëveshje me Bashkinë e Tiranës, duke konfirmuar përjashtimin e VUSH-it nga këto taksa. Megjithatë, disa qeveri vendore vijuan të vendosin gjopa për mospagesën e taksave të tjera, si taksat mbi shitjet, dhe administratorëve të VUSH-it iu desh t'i apelonin ato, me shkallë të ndryshme suksesi.

Përfaqësuesit nga komunitetet katolik, ortodoks dhe bektashian vazhduan të pretendonin se numri i besimtarëve të tyre sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë të vitit 2011 paraqitet më i vogël se numri real, duke dhënë një pamje të pasaktë të demografisë fetare të vendit.

### **Seksioni III. Gjendja e respektimit të lirisë së fesë nga ana e shoqërisë**

Edhe pse Këshilli Ndërfetar është ngritur që komunitetet fetare të vendit të diskutojnë shqetësimet e përbashkëta, komunitetet fetare raportuan se deri në fund të vitit nuk ishin organizuar mbledhje të tilla dhe ai nuk kishte funksionuar si një forum për të diskutuar apo shpallur deklarata të përbashkëta, në ndryshim nga viti i kaluar.

Disa politikanë vazhduan të kritikojnë Kryepeshkopin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për Tiranën, Durrësin dhe gjithë Shqipërinë për lidhjet që sipas perceptimit të tyre ai ka me qeverinë greke.

Më 11 maj, Papa Françesku priti në një audiencë në Romë Haxhi Dede Edmond Brahimaj, kryetarin e Qendrës Botërore Bektashiane me seli në Tiranë. Audiencia ishte e para e këtij lloji për një udhëheqës fetar të vendit me Papën.

Në 12 nëntor, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Myftiu Skënder Bruçaj, mirëpriti në vend skuadrën e futbollit izraelite për një ndeshje kualifikuese për Kupën Botërore, ku citoi tolerancën dhe harmoninë fetare të vendit.

### **Seksioni IV. Politikat e Qeverisë së SHBA**

Zyrtarë të ambasadës vazhduan të takohen me komisionerin shtetëror të kulteve dhe ATP-në, për të nxitur qeverinë të përshpejtojë shqyrtimin e pretendimeve për pronat fetare dhe t'u kthejë grupeve fetare ndërtesat, tokën dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës vazhduan të ndërveprojnë me drejtuesit fetarë dhe anëtarët e komuniteteve myslimane suni, bektashiane, katolike, ortodokse dhe protestante, si dhe të vizitojnë kisha, xhami dhe vende fetare për të nxitur tolerancën fetare. Ambasadori shtroi një iftar për anëtarë të këtyre komuniteteve të ndryshme, ku theksoi vlerën e tolerancës dhe dialogut fetar.

Ambasada vazhdoi të punojë me komunitetet fetare, së bashku me aktorë joqeveritarë, për të ulur mundësinë e tërheqjes ndaj ekstremizmit të dhunshëm të lidhur me fenë mes të rinjve të vendit. Ambasada e vazhdoi programin e saj të edukimit qytetar, gjatë të cilit zyrtarë të ambasadës nxitën tolerancën duke u folur nxënësve në shkolla fetare myslimane, katolike, ortodokse, shkolla të mesme publike, dhe institucione të tjera arsimit. Si pjesë e programit, nxënës nga institucione të ndryshme fetare arsimore, krijuan dhe zhvilluan projekte që kremtonin diversitetin fetar. Për më tepër, seminarë me figura kryesore fetare dhe diskutime me udhëheqës të qeverisë, zbatimit të ligjit, dhe akademisë, nënvizuan përputhshmërinë midis demokracisë dhe besimit fetar.